



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVA- MUNICIPALITY OF GJAKOVA

PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE DREJTORIA PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONË

SHKURT 2024



Ky dokument është realizuar me mbështetje nga popullit amerikan përmes Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Tetra Tech/ARD dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

HYRJJE

Me mbështetjen e Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës (PGA), në komunën e Gjakovës përkatësisht në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë (DGJKP) është realizuar një vlerësim i proceseve aktuale të ofrimit të shërbimeve, është dokumentuar koha e nevojshme për ofrimin e shërbimeve, janë vlerësuar kapacitetet njerëzore dhe institucionale për qasje dhe mirëmbajtje konsistente të të dhënave sipas modelit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK), janë identifikuar opsionet për të bërë automatizimin e shërbimeve dhe përmirësuar qasjen e qytetarëve në këto shërbime si dhe ka analizuar kornizën rregulluese të drejtave pronësore, procedurave dhe praktikave, me qëllim që të identifikohen dhe dokumentohen mospërputhjet ose devijimet *vis-a-vis* legjislacionit në fuqi, përfshirë këtu edhe procedurat e ankimit. Po ashtu në kuadër të vlerësimit është analizuar se a ka ndonjë sjellje diskriminuese e cila mund të pengojë gratë në qasje dhe në marrje të shërbimeve kadastrale efikase dhe të barabarta.

Me qëllim të adresimit të gjitha të gjeturave nga ky vlerësim, Komuna e Gjakovës me mbështetje nga AQP, ka realizuar një punëtori dy ditore më 05 dhe 06 Shkurt 2024, me pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha dikasteret e Komunës së Gjakovës dhe përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Punëtorja është mbajtur në 3 (tri) grupe tematike të punës: Grupi I-Gjeodezi dhe Kadastrë, Grupi II–Pjesa Ligjore dhe Grupi III-Përfshirja Gjinore dhe Sociale.

Planin i Përmirësimit të Ofrimit të Shërbimeve përmban të gjeturat nga raportet e vlerësimit dhe ofron rekomandime konkrete për përmirësimin e kualitetit dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve nga DGJKP. Ky dokument ka detajuar veprimet për zbatimin e rekomandimeve, duke identifikuar të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren, autoritetet përgjegjëse, ndikimet buxhetore, afatet kohore si dhe rreziqet dhe sfidat që do të afektonin në arritjen e qëllimeve të parapara në plan.

PGA në vazhdimësi do të asistojë Komunën e Gjakovës në mënyrë që rekomandimet nga ky plan, të konkretizohen me veprime konkrete, në të njëjtën kohë, ky plan do të mbikëqyret dhe raportohet për nivelin e zbatimit të tij nga DGJKP Gjakovë, Komiteti për Praktika të Mira dhe Forumi për Transparencë të Pronës.

SHKURTESAT

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
DAP	Drejtoria e Administratës Publike
KK	Kuvendi Komunal
LBGJ	Ligji për Barazi Gjinore
LK	Ligji për Kadastër
LPPA	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
PGA	Aktiviteti Qeverisja e Pronës
RDPP	Regjistri i të Drejtave të Pronës së Paluajtshme
SIKTK	Sistemi i Informacionit Kadastral për Tokat në Kosovë
UA	Udhëzim Administrativ
ZBGJ	Zyra për Barazi Gjinore

PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE KADASTRALE - KOMUNA GJAKOVË

PJESA E KADASTRIT DHE GJEODEZISË

Nr.	TË GJETURAT	Nr.	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	Mos unifikimi i ofrimit të shërbimeve në sportele	1	Kalimi në zyrë të reja të Komunës	Zhvendosja-bartja në objektin e ri	Komuna	Nuk ka	Q2 - 2024	Vonesa në përfundim të punimeve
		2	Pjesa e veçantë e sporteleve për ZKK-në	Kërkesë tek Drejtoria e Administratës për informata mbi planin	Drejtori i ZKK-së dhe Drejtoria e Administratës	Nuk ka	Q1 - 2024	Pamundësia e ndryshimeve në projekt
		3	Fletëpalosje dhe lista e dokumentacioni për secilën lëndë	Printimi i fletëpalosjeve dhe udhëzuesit e ri nga AKK	AKK, ZKK dhe PGA	3,000	Q2 - 2024	Vonesa në hyrjen në fuqi të UA dhe përpilimin e Udhëzuesve të punës nga AKK
		4	Duhet të bëhet kontrolli fillestar i kualitetit të dokumentacionit që dorëzohet, në mënyrë që të mos lejohet mundësia që dokumentacioni të dorëzohet në ZKK i pa kompletuar	Në sportel të jetë një zyrtar i Kadastrit, trajnimi i zyrtarit	AKK, ZKK dhe PGA	-	Q2 - 2024	Vonesa në përfundim të punimeve. Për momentin nuk parashihen ndryshime deri në zhvendosjen në objektin e ri
		5	I gjithë komunikimi qytetarë-zyrtarë duhet të realizohet në sportel (përgjashtimisht konsultave më në detaje në zyrën pritëse)	Në sportel të jetë një zyrtar i Kadastrit, trajnimi i zyrtarit	AKK, ZKK dhe PGA	-	Q2 - 2024	Vonesa në përfundim të punimeve. Për momentin nuk parashihen ndryshime deri në zhvendosjen në objektin e ri
		6	Monitor informues për qytetarët, lidhur me proceset e ofrimit të shërbimeve kadastrale dhe informata të përgjithshme kadastrale	Kërkesë nga ZKK për monitor në sportelin e ZKK-së	ZKK, DA	300	Q2 - 2024	Vonesa në përfundim të punimeve. Për momentin nuk parashihen ndryshime deri në zhvendosjen në objektin e ri
2	Zyra pritëse	1	Të krijohet zyra pritëse, me hapësirë më të madhe në objektin e ri të Komunës	Kërkesë tek Drejtoria e Administratës për informata mbi planin	Drejtori i ZKK-së dhe Drejtoria e Administratës	Nuk ka	Q1 - 2024	Pamundësia e ndryshimeve në projekt
		2	Caktimi i orarit me qytetarë dhe palë të tjera (gjeodetë etj)	Vendim i Drejtorit të ZKK	Drejtori i ZKK-së	Nuk ka	Q2 - 2024	Nuk parashihen rreziqe
		3	Zyra pritëse të jetë e pajisur me inventar të nevojshëm dhe PC, Printer etj	Kërkesë tek Drejtoria e Administratës	ZKK, DA	1,000	Q2 - 2024	Pamundësia e ndryshimeve në projekt

3	Zyra kryesore	1	Ndarja e zyrës kryesore punuese minimum sipas sektorëve.	Kërkesë tek Drejtoria e Administratës për informata mbi planin	Drejtori i ZKK-së dhe Drejtoria e Administratës	5,000	Q1 - 2024	Pamundësia e ndryshimeve në projekt
		2	Të mos lejohen qytetarët dhe palët tjera të kenë qasje në zyrën kryesore	Orari i punës me palë në zyrën pritëse	Drejtori i ZKK-së	Nuk ka	Q2 - 2024	Nuk parashihen rreziqe
4	Hapësira e vogël e arkivës së ZKK-së	1	Të ketë hapësirë më të madhe për arkivimin të dokumentacionit, dhe të plotësohen standardet e arkivimit	Zhvendosja-bartja në objektin e ri, dhe të jetë pjesë e vecantë e arkivës së ZKK-së	Komuna	Nuk ka	Q2 - 2024	Vonesa në përfundim të punimeve
5	Nevoja e ri-organizimit të sektorëve në ZKK	1	Ndarja e Drejtorisë në tre sektorë: 1. Sektori i Gjeodezisë, 2. Sektori i Kadastrit dhe 3. Sektori i Pronës	Kërkesa tek Komisioni për hartimin e rregulloreve për harmonizimin e vendeve të punës në KK Gjakovë.	Drejtori i ZKK-së	250euro/muaj	Q3 - 2024	Mos implementimi i organogramit
		2	Punësimi i një zyrtari jurist	Kërkesa nga ZKK-të tek zyra e burimeve njerëzore	ZKK dhe ZBNJ	550euro/muaj	Q3 - 2024	Mos implementimi i organogramit
6	Sigurimi i 1 skaneri shtesë	1	Kërkesë tek operatori ekonomik për sigurimin e 1 skaneri shtesë	Kërkesa nga Drejtoria e ZKK-së tek OE	ZKK dhe AQP	-	Q2 - 2024	Mos zbatimi i kërkesës së ZKK-së për skaner
7	Mungesa e softuerë adekuat përkatësisht Autocad dhe GIS	1	Blerja e Licencës për AutoCad dhe shfrytëzimi i QGIS	Kërkesa nga Drejtoria e ZKK-së tek Drejtoria e Administratës	ZKK, DU dhe Zyra e Prokurimit	20,000	Q3 - 2024	Dështimi i blerjes së licencës në procedurat e tenderimit
8	Ofrimi i shërbimit të bartjes së pronësisë më shumë se 30 ditë	1	Të lëshohen Aktvendimet pezulluese	Lëshimi i aktvendimit pezullues nga zyrtari i lëndës	ZKK	-	Q1 - 2024	-
9	Ofrimi i shërbimit të ndarjes dhe bashkimit të parcelave ka raste kur bëhet mbi 15 ditë	1	Të lëshohen Aktvendimet pezulluese	Lëshimi i aktvendimit pezullues nga zyrtari i lëndës	ZKK	-	Q1 - 2024	-
10	Funksionalizimi i E-kioskave me produkte kadastrale	1	Certifikata e pronësisë të lëshohet edhe nga E-kioska	Kërkesa nga Drejtoria e ZKK-së, tek Drejtoria e Administratës dhe AKK	ZKK, DA dhe AKK	-	Q2 - 2024	Pamundësia e instalimit të ueb shërbimit të AKK-së në E-kiosk

PJESA LIGJORE							
Nr.	TË GJETURAT	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUGJETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	Vendimi për regjistrim nga ana e ZKK-së në disa raste nuk lëshohet brenda afatit të paraparë ligjor brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, vonesat janë më të theksuara sidomos gjatë periudhës së sezonit veror.	LK përcakton se ZKK-ja duhet të bëjë regjistrimin e të drejtës mbi pronën e paluajtshme, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, prej ditës së pranimi të kërkesës për regjistrim dhe të njoftojë parashtruesin e kërkesës.2. Në të gjitha rastet kur dokumentacioni nga parashtruesit e kërkesave është i mangët, të pezullohet lënda dhe të kërkohej me shkresë nga palët plotësimi i kërkesës.	Sipas pikës 5.2 të pjesës Gjeodezi dhe Kadastër	Sipas pikës 5.2 të pjesës Gjeodezi dhe Kadastër	Sipas pikës 5.2 të pjesës Gjeodezi dhe Kadastër	Sipas pikës 5.2 të pjesës Gjeodezi dhe Kadastër	Sipas pikës 5.2 të pjesës Gjeodezi dhe Kadastër
2	ZKK-ja shpall njoftime dhe lëshon vendime vetëm në gjuhën shqipe	Komuna duhet të respektojë dispozitat e ligjit dhe të publikojë njoftimet jo vetëm në gjuhën shqipe por edhe në gjuhën serbe. Vendimet individuale duhet poashtu të lëshohen në gjuhën serbe, ne rastet kur kërkohej nga ana e parashtruesive të kërkesave.	Të dërgohen për përkthim nga ZKK në gjuhën serbe njoftimet e ZK-së te përkthyesi i kuvendit komunal. Të përkthehen poashtu vendimet individuale në gjuhën serbe, sipas kërkesës së parashtruesve të kërkesave	ZKK	Nuk ka	Q1 - 2024	Nuk ka

3	<p>ZKK-ja, në shumicën e rasteve, nuk i regjistron njësitë e reja të parcelave brenda tri ditëve të punës pas pranimit të kërkesës për regjistrim sipas udhëzimeve të AKK-së.</p>	<p>Ligji i ri për Kadastër të Pronës së Paluajtshme përcakton se afati për regjistrim të njësive të reja do të jetë 15 ditë. Udhëzimi Administrativ për krijimin dhe regjistrimin e njësive të reja kadastrale është në procedurë dhe pritet të hyjë në fuqi në Prill 2024.</p>	AKK	ZKK	Nuk ka	Q2 - 2024	Nuk ka
4	<p>Disa shërbime kadastrale (ndryshim pronari) dhe të urbanizmit kushtëzohen me vërtetimin e tatimit në pronë, për të dëshmuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka obligime tatimore të papaguara</p>	<p>Rregullorja nr. 07/2021 mbi Pezullimin e Shërbimeve Komunale për Mbledhjen e Detyrimeve të Papaguara të Tatimit në Pronë është shfuqizuar nga Ministria e Financave nga 2 tetor 2023. Rekomandohet që të mos kushtëzohen palët me ofrim të shërbimeve me vërtetimin e tatimit në pronë</p>	<p>Zyra Ligjore në kuadër të kabinetit të Kryetarit të Komunës, duhet ti njoftoj të gjitha drejtoritë komunale për shfuqizim të rregullores dhe të mos kërkohet vërtetimi i tatimit në pronë për ofrim të shërbimeve komunale duke përfshirë ato të urbanizmit dhe kadastrale</p>	Zyra Ligjore	Nuk ka	Q1 - 2024	Nuk ka

BARAZIA GJINORE DHE PERFSHIRJA SOCIALE

Nr.	TË GJETURAT	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	<p>Udhëzimi Administrativ (QKR) 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pasurisë së përbashkët të paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve, i ndryshuar dhe plotësuar me UA (KKR) 04/2017, është derivat i masave të përkohshme afirmative të përcaktuara me Ligjin për Barazinë Gjinore.</p> <p>Të shqyrtohen masa të tjera afirmative për të rritur regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve. Të përfshihet në akte noteriale e drejta e pronësisë të regjistrohet në emër të dy bashkëshortëve.</p>	<p>Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) ta bëjë të përhershme masën afirmative dhe ta zgjeroj edhe te nënat vetushqyese (grupet ma të cenueshme), etj.</p> <p>Zyrtarët komunalë të organizojnë fushata vetëdijësuese për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i fushatës vetëdijësuese; Tryeze diskutimi me akterë të ndryshëm; Vendosja e posterëve me mesazhe senzibilizuese; Video promovuese në rrjete sociale dhe media sociale, duke targetuar familjet dhe dinamikat e marrëdhënies brenda saj Ligjërata vetëdijësuese me nxënësit e shkollave të mesme për rëndësinë e të drejtave pronësore; Takime informuese me qytetarët në qytet dhe vende rurale përmes përfaqësuesve të këshillave lokale. Trajnimi i mëtutjeshëm i noterëve për të siguruar qasjen e drejtë të grave në pronë dhe trashëgimi. 	<p>Zyra për barazi gjinore, Drejtoria për Kadastër, Drejtoria e Financave, Oda e noterëve, OJQ-të.</p>	4,500 Euro	<p>Prill 2024, me vazhdimësi.</p> <p>Të kemi parasysh të përfshihet në rishikim buxhetor.</p>	<p>Mungesa e planifikimit buxhetor, mungesa e pjesëmarrjes së duhur në aktivitetet të ngritjes së vetëdijes.</p> <p>Mungesa e kohës së noterëve për të marrë pjesë në trajnime në këtë temë.</p>
2	<p>Duhet te krijohen masa dhe të ndermirën veprime të veçanta për mbështetjen e grave, komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian si dhe të rinjve për zhvillim te qëndrueshëm ekonomik në nivel komunal, me qëllim te fuqizimit social.</p>	<p>Krijimi i një fondi komunal të përhershëm për t'u ndihmuar grave në biznes, e posaçërisht grave që fillojnë biznese të reja;</p> <p>Në këtë duhet të përfshihen edhe komunitetet dhe të rinjtë;</p> <p>Të krijohen mundësi për grante të vogla për blerje të pajisjeve prodhuese dhe përpunuese, gjithashtu në fushën e bujqësisë: subvencionimin me bagëti apo pajisje në bujqësi;</p> <p>Të shikohen mundësitë e prioritizimit (gjatë poentimit) të aplikantëve të cilët e kanë të regjistruar pronën në emër të dy bashkëshortëve, nënat vetushqyese, gjatë ndarjes se granteve dhe subvencioneve në fusha të ndryshme në komunë.</p>	<p>Planifikimi i hershëm i buxhetit në baza vjetore nga DZHE, mbi parimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor; Të zbatohet LBGJ dhe masat e veçanta në implementimin e ndarjes së subvencioneve në komunë. Të organizohen sesionet informuese për plotësimin e dokumentacionit (p.sh përgatitja e biznes planit dhe dokumenteve përcjellëse).</p>	<p>Zyra e Kryetarit, DZHE, DBF, Zyra për Komunitete dhe Kthim, ZBGJ, Asambleja Komunale (nëse ka nevojë).</p>	<p>Të shikohen mundësitë me DZHE që në buxhetin ekzistues për grante dhe subvencione të aplikohet kriteri i barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale (të komuniteteve). I rekomandohet komunës që të rrisë buxhetin për biznese të grave gjatë rishikimit të buxhetit.</p> <p>I propozohet Komunës që në planifikimin e buxhetit 2025, të ketë fond të veçantë të përkrahjes së grupeve të lartpërmendura, me së paku 80,000 Euro.</p>	<p>Mars 2024, hapi i konsultimit me komunë për ndarje të buxhetit ekzistues.</p> <p>Maj 2024 konsultimit me komunë për procesin e rishikimit buxhetor.</p> <p>Gusht-Shtator planifikimi i buxhetit 2025.</p>	<p>Mungesa e buxhetit, mungesa e prioritizimit në ndarje buxhetore për grupet e lartcekura.</p>

3	<p>Nxitja e debatit social nga zyrtarët për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut, përfshirë drejtorët dhe përfaqësuesit e zyrave të ndryshme në komune, si dhe asamblistëve, për t'i informuar gratë dhe burrat, përfshirë edhe komunitetet, për rëndësinë e realizimit të së drejtës në trashëgimi.</p>	<p>Informata rreth legjislationit në fuqi për gratë dhe grupet tjera të cënueshme. Ngritja e vetëdijes të burrave për të drejtat pronësore të grave.</p> <p>Të zbatohen procedurat të noteri sa i përket marrjes së deklaratës në proceset e trashëgimisë, dhe shitblerjeve në mënyrë që gruas të sigurohet qasja e drejtë në pronë dhe trashëgimi.</p>	<p>Të sigurohen resurse të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për zyrtarët e barazisë gjinore dhe zyrtarët tjerë komunal që të ndërmarrin fushata vetëdijësuese, me theks të veçantë në viset rurale dhe vendbanimet e komuniteteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i fushatave vetëdijësuese • Tryeze diskutimi me akterë të ndryshëm • Vendosja e posterëve me mesazhe senzibilizuese në faqe të komunës, mediat, rrjete sociale etj. • Organizimi i takimeve informuese me qytetarët në qytet dhe vende rurale përmes përfaqësuesve të këshillave lokale. 	<p>Zyra për barazi gjinore dhe të drejta të njeriut, Këshillat Lokale, OJQ-të lokale, Drejtoria e Kadastrës, Zyra për komunitete dhe kthim</p>	<p>3,500 Eur</p>	<p>Maj 2024 të filloj dhe pastaj të vazhdojnë gjatë tërë vitit.</p>	<p>Mungesa e planifikimit buxhetor, mungesa e pjesëmarrjes së duhur në aktivitetet të ngritjes së vetëdijes.</p>
4	<p>Të lehtësohet qasja e personave me nevoja të veçanta në shërbimet komunale që lidhen me pronë e kadastër.</p>	<p>Problemi qëndron te personat me të pamur të dëmtuar, me probleme me dëgjim dhe qasja e personave në karrocë.</p> <p>Të ngritet vetëdija për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe proceseve të trashëgimisë për këtë kategori.</p>	<p>Organizimi i punëtorive me përfaqësuesit e OJQ-ve nga fusha e nevojave të veçanta për të identifikuar saktësisht nevojat dhe problemet me të cilat ballafaqohet kjo kategori. Të organizohen fushata vetëdijësuese për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe proceseve të trashëgimisë.</p> <p>Komuna të angazhohet për sigurimin e pajisjeve (kompjuterit me alfabetin e brajllit), interpret për gjuhën e shenjave, shiritat për ecje për persona me të pamur të dëmtuar, ofrimi i qasjes fizike për personat në karroce.</p>	<p>Njësia për të drejtat e njeriut në bashkëpunim me shoqatat e përfaqësuesve të kategorive me nevoja të veçanta.</p>	<p>Buxhet për punëtorit dhe fushata vetëdijësuese.</p> <p>Buxhet komunal dhe/apo nga donatorët për paisje për persona me nevoja të veçanta si dhe rregullimi i infrastrukturës. Potencialisht kosto shtesë për dhëniën e shërbimeve për gjuhën e interpretëve.</p>	<p>Fillimi i vitit 2024 e tutje.</p>	<p>Mungesa e buxhetit dhe pamundësia e sigurimit të mjeteve, pajisjeve përkatëse.</p>
5	<p>Të shqyrtohet mundësia e lirimit nga tatimi në pronë për 50%, për periudhën 2 vjeçare kur prona regjistrohet në emër të dy bashkëshortëve ose në emër të gruas.</p>	<p>Vendimi nga asambleja komunale për masën afirmative.</p>	<p>Takimet konsultative paraprake me MAPL dhe MEF.</p> <p>Fushata informuese për vendimin pas miratimit të tij.</p>	<p>Kuvendi komunal</p>	<p>Ka ndikim në të hyrat e komunës, në varësi prej vlerësimit të patundshmërisë.</p>	<p>Të fillohet me planifikim në muajin Qershor 2024, ndërsa me implementim në muajin Janar 2025.</p>	<p>Zvogëlimi i të hyrave nga tatimi në pronë; konfirmimi i ligjshmërisë së vendimit nga MF dhe MAPL.</p>